

VENDIM
Nr.425, datë 11.7.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.296, DATË 6.5.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT TË
STRATEGJISË KOMBËTARE TË MIGRACIONIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9668, datë 18.12.2006 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.296, datë 6.5.2005 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 të ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Ngarkohet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për bashkërendimin e punës dhe monitorimin e zbatimit të planit kombëtar të veprimit të Strategjisë Kombëtare të Migracionit.”.

2.Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Ngarkohen Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministri i Brendshëm, Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Integritetit, Ministri i Financave, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Banka e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha